



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2015
Nr. Dok. 201500495/2

Lënda: *Rekomandim lidhur me aplikimin e ndjekjes penale në gjendje të lirë dhe masa sigurimi më të buta se "arresti në burg" ndaj autorëve të veprave penale "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike", parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe "Ndërtimi i paligjshëm", parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal".*

Drejtuar: **Ministrit të Punëve të Brendshme**
Z. Saimir TAHIRI

Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit (i komanduar)
Z. Haki ÇAKO

Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

Ministrit të Drejtësisë
Z. Nasip NAÇO

Këshillit të Lartë të Drejtësisë

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Nga ankesat e ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit, nga inspektimet e kryera në ambientet e sigurisë në Organet e Policisë së Shtetit dhe në IEVP-të, në të gjithë vendin, si dhe nga informacionet e ndryshme të bëra publike në media, konstatojmë se:

Muajt e fundit nga Organet e Policisë së Shtetit janë bërë "Arrestime në flagrancë" të një numri të konsiderueshëm të shtetasve për arsye se dyshohen si autorë të veprave penale "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve

telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, të ndryshuar dhe “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, të ndryshuar. Sipas raportimeve të bërë në media nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ditët e fundit numri i të arrestuarve në flagrancë nga ky organ çdo ditë në të gjithë vendin, vetëm për vjedhje të energjisë elektrike shkon deri në 20 persona.

Në raste të tjera, kur kanë shkuar grupet e kontrollit të OSHEE apo INUK-ut (IKMT-së) dhe, pas konstatimeve kanë përpiluar proces verbalet përkatëse, qytetarët janë larguar nga banesa, apo në raste të veçanta kanë marrë vendim ekstrem duke i dhënë fund jetës, për të mospranuar burgimin.

Është rasti të kujtojmë se çdo person i paraburgosur apo i dënuar i kushton shoqërisë tonë rreth 496 Euro në muaj. Ndërkohë arrestimi i një personi sjell pasoja sociale, ekonomike e psikologjike në familjen përkatëse dhe më gjërë në rrethin miqësor e shoqëror të tij.

Është e rëndësishme që të theksojmë se, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk është kundër ndjekjes penale dhe dënimit të autorëve të këtyre veprave penale. Ndërkohë konstatojmë se, aktualisht ambientet e sigurisë në Organet e Policisë së Shtetit dhe në IEVP-të në vend, sidomos ato të paraburgimit, janë të tejmbushur dhe pothuajse me dyfishin e kapacitetit të tyre me persona ndaj të cilëve policia gjyqësore ka aplikuar “arrestin në flagrancë” dhe gjykatat kanë caktuar masën e sigurisë “arrest në burg”.

Nga informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i datës 17 Mars 2015, rezulton se në institucionet e paraburgimit ka një mbipopullim prej 1190 personash, nga të cilët vetëm për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike” janë 200 persona.

Gjithashtu konstatojmë se, ambientet ku mbahen, ruhen e trajtohen këta persona nuk sigurojnë as kushtet dhe standardet minimale, të garantuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm, për jetesë të kësaj kategorie personash. Kështu, mund të përmendim mungesën e hapësirës së nevojshme në dhomat e sigurisë dhe në qelitë, mungesën e krevatëve, të dyshekëve, mungesën e asistencës sociale, të kujdesit shëndetësor, të medikamenteve mjekësore, të drejtën për të dalë në ajrim, etj.

Për shkak të mbipopullimit, të mungesës së kapacitetit dhe të kushteve materiale minimale të ambienteve ku mbahen e trajtohen aktualisht, personave të arrestuar dhe të paraburgosur po iu cënohen të drejtat ligjore.

Me të drejtë Prokuroria e Përgjithshme në datën 19.09.2014, me shkresën nr. 1539/3 nxorri qarkoren “Për kuptimin dhe zbatimin e unifikuar të nenit 199/a të Kodit Penal”. Kjo për faktin se në disa prokurori të rretheve gjyqësore ishin ngritur shqetësime për problematika dhe qëndrime të ndryshme ligjore në praktikën e ushtrimit të ndjekjes penale në prokurori dhe në praktikën gjyqësore lidhur me kuptimin dhe zbatimin e nenit 199/a të Kodit Penal.

Do të sugjerohet që një qarkore e tillë duhet të nxirrej dhe për kuptimin dhe zbatimin e unifikuar të nenit 137/1 të Kodit Penal, pasi në praktikën gjyqësore

në disa raste gjykata ka deklaruar të pafajshëm të akuzuarit për këtë veprë penale. Një rast i tillë përshkruhet në vendimin nr. 2120, datë 22.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë, ku shtetasi Sh.B. është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale “Vjedhja e energjisë elektrike”. Gjykata në vendimin e saj ka arsyetuar mungesën e elementëve të veprës penale si, anës objektive ashtu dhe asaj subjektive. Më konkretisht, sipas gjykatës personi i akuzuar duhet të realizojë lidhjen me rrjetin e energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, pa patur kontratë për konsumimin e kësaj energjie me subjektet që operojnë në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, të konsumojë energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme dhe të mospaguajë shumën që i korespondon sasisë së konsumuar të energjisë elektrike. Pra, personi duhet të ketë si qëllim mospagimin tërësisht apo pjesërisht të sasisë së konsumuar të energjisë elektrike.

Ndërkohë sjellim në vëmendje se në vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj autorëve të dyshuar të këtyre dy veprave penale duhen mbajtur në konsideratë kushtet dhe kriteret e caktimit të tyre të parashikuara nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 228, 229 dhe 230 të tij.

Sipas nenit 228/3 të K.Pr.Penale masat e sigurimit personal vendosen:

a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;

b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Sipas nenit 229/1 e 2 të K.Pr.Penale, në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.

Ndërsa sipas nenit 230/1 të K.Pr.Penale, arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër siguri është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.

Për aplikimin e masës së sigurisë arrest në burg duhet mbajtur parasysh rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe e autorëve të saj. Sipas gjykimit tonë, rrezikshmëria shoqërore e këtyre dy veprave penale dhe e autorëve të tyre nuk është e lartë. Ky fakt provohet edhe nga masa e dënimit të parashikuara nga dispozitat ligjore përkatëse respektivisht, deri në 3 vjet burg për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike” parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, dhe me gjobë ose deri në 1 vit burg për paragrafin e parë të nenit 199/a të Kodit Penal për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, si dhe deri në 5 vjet burg për paragrafin e dytë të po këtij neni.

Është me rëndësi që të theksojmë se, qëllimi i rëndësishëm është edhe shlyerja e detyrimit që kanë debitorët duke përfshirë edhe personat e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve

telefonike”, ndërsa duke aplikuar masën e arrestit në burg, e vështirëson një gjë të tillë.

Ndërkohë gjykojmë se, nuk duhet anashkaluar edhe fakti shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me qëndrimin jo konsistent të shtetit ndaj këtij fenomeni gjatë viteve të fundit.

Dihet botërisht se për shumë vite, ndonëse këto dy figura të veprave penale kanë qënë të përfshira në Kodin Penal, respektivisht vjedhja e energjisë elektrike që në vitin 2001, ndërsa ndërtimi i paligjshëm që në vitin 2008, ato pothuajse nuk janë zbatuar nga organet kompetente shtetërore. Gjithashtu nuk janë të pakta rastet që, herë pas here nga shteti është aplikuar falje për energjinë elektrike të pa paguar nga qytetarët abonent.

Po kështu mund të thuhet edhe lidhur me ndërtimet e paligjshme, të cilat janë “nxitur” e “stimuluar” nga shteti nëpërmjet procesit të legalizimit, i cili megjithëse ka patur afate përfundimi, por në fakt është shtyrë disa here. Pra, institucione të ndryshme shtetërore me sjelljen dhe qëndrimin e mbajtur ndaj këtyre dy fenomeneve që aktualisht përbëjnë vepra penale, në një farë mënyre kanë lejuar qytetarët të konsumojnë elementët e këtyre dy figurave të veprave penale në fjalë.

Standardi kryesor veprues për privimin e lirisë së personit nëpërmjet arrestimit është **arsyeshmëria**. Dispozitat e legjislacionit të brëndshëm dhe atij ndërkombëtar, presupozojnë që shteti duhet ta bazojë arrestimin, të paktën mbi një nivel të caktuar provash për të vërtetuar faktin se është kryer një veprim i kundërligjshëm dhe se i arrestuari ka një lidhje të mjaftueshme me veprën në fjalë. Pra dyshimi i arsyeshëm duhet të jetë i bazuar në fakte.

Sipas nenit 5 të KEDNJ, arsyet për arrestimin e personit duhet të jenë specifike dhe të ligjshme. Gjykata Europiane të Drejtave të Njeriut është shprehur gjithashtu se vërtet është thelbësore ekzistenca e një dyshimi, por ky dyshim nuk është i mjaftueshëm, për të zgatur arrestimin apo ndalimin pas një periudhe të caktuar. Një periudhë të tillë e përcakton dhe legjislacioni ynë procedural penal, e cila në praktikë nuk zbatohet për shkak të ngarkesës së punës ose dhe numrit të madh të arrestimeve apo ndalimeve.

Në nenet 4, 17, 18, dhe 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet në mënyrë të qartë se, kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë duhet të jenë në përpjestim me gjëndjen që e ka krijuar atë. Sipas pikës 2 të nenit 17 të Kushtetutës, këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndodhur në këto rrethana, gjykojmë se arrestimi në masë i autorëve të dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike dhe impulsive telefonike” dhe për “Ndërtim të paligjshëm”, nuk është masë e drejtë dhe proporcionale.

Vendosja e masës së arrestimit në flagrancë të autorëve të veprave penale nga Policia Gjyqësore, i masës së ndalimit nga ana e policisë gjyqësore ose prokurorisë, si dhe kërkesa e prokurorisë drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” duhet të aplikohet si rast përjashtimor dhe si masë e fundit për personat e dyshuar si autorë të kryerjes së veprave penale të cilat parashikojnë dënime të rënda penale. Kjo masë e fundit duhet të aplikohet në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit, të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikon vepra penale, si dhe kur masat e tjera nuk janë të përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj.

Shprehim mendimin se nga organet e drejtësisë duhet të rritet përgjegjësia në në procesin e gjyimit të autorëve të veprave penale duke vlerësuar edhe pasojat sociale dhe ekonomike që sjell dënimi me burgim.

Pra, prokurori dhe gjyqtari duhet të bëjë një vlerësim të tipareve të veçanta të veprës penale, por gjithmonë me paanshmëri dhe ekuilibër. Në tekset e deontologjisë gjyqësore përmëndet qartë, kuptimi i kontekstit, rrethanave konkrete dhe arsyeve të veçanta të faktit i cili duhet të derivojë në sjellje e vendime në favor të subjekteve më të dobëta. Kjo duhet të ndikojë dhe në caktimin e dënimit me burgim, vetëm kur ai është i pashmangshëm dhe në masën minimale të parashikuar në ligj, si dhe në aplikimin e dënimeve të tjera alternative të cilat nuk janë të pakta. Në aplikimin e masës së dënimit me burgim, nuk mund të injorohet edhe parimi, sipas të cilit ky lloj apo formë dënimi të moskonsistojë **në trajtime antihumane**.

Pra, është e domosdoshme që shteti sa më parë të ripërcaktojë me masa konkrete dhe efçente të drejtat e njeriut edhe kufizimet, por edhe garancitë. Për problemet e trajtuara, në interesin e publikut të gjërë, shteti duhet të gjejë forma dhe mënyra për sensibilizimin e opinionit, njohjen e tij me ligjet e veprat penale të cilat pësojnë ndryshime të herëpashershme.

Për të gjitha arsyet dhe shkaqet e përmendura më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në nenin 21/b të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË :

Që ndaj autorëve të veprave penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, të ndryshuar, dhe për “Ndërtim të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, të ndryshuar, të aplikohet ndjekje penale në gjëndje të lirë dhe masa sigurimi personal më të buta se sa “arrest në burg”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**Me respekt
AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI**

**Në mungesë dhe me porosi
K O M I S I O N E R I**

Arben SHKËMBI